



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



STANDARDE **ETIKE** PËR VETËVLERËSIM

2023

Ky dokument është përgatitur në kuadër të projektit “Mbështetje për Reformat Zgjedhore” i financuar nga Qeveria e Zvicrës dhe i zbatuar nga Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore (IFES). Pikëpamjet, opinionet dhe përmbajtja e shprehur në këtë dokument nuk pasqyrojnë doemos pikëpamjet e donatorit, projektit ose zbatuesit.

Qëllimi i këtij dokumenti është të kontribuojë në krijimin e një kulture dialogu, respekti reciprok dhe mirëkuptimi të argumentit të Tjetrit, me dëshirën që ai të jetë një *përkujtues* i përditshëm i asaj që (të mos) bëjnë dhe çfarë nuk duhet të harrojnë të rinjtë apo politikanët e ardhshëm dhe bartës të pozitive publike gjatë karrierës së tyre politike.

Fushëveprimi i politikanëve është gjithmonë më i gjerë se sjelljet e mundshme të rregulluara me ligj apo ndonjë akt tjetër. Është pikërisht kjo fushë e pashënuar e veprimit që e vë politikanin përballë dilemave dhe pyetjeve të veta etike. Si duhet të veproj? Si duhet të flas? Si mundet që veprimet apo fjalët e mia të mos dëmtojnë tjetrin deri në atë pikë sa të degradojnë apo shkatërrojnë kundërshtarin politik? Si mund të ndikoj në shoqëri me veprimet dhe fjalët e mia, duke mos krijuar një fushë përçarjeje apo mosdurimi të cilat nuk duhet të ekzistojnë në hapësirën politike? Këto pyetje dhe dilema janë pikëpamjet origjinale që duhet të udhëheqin çdo politikan që dëshiron të jetë i mirë, përkatësisht i virtytshëm në veprimet e tij/saj në sferën publike.

Standardet etike për vetëvlerësim i hartuan alumnistët e Akademisë së Politikave Publike (në kuadër të projektit “Mbështetje për Reformat Zgjedhore” i financuar nga Qeveria e Zvicrës dhe i zbatuar nga Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore-IFES me mbështetjen e Forumit për politika të arsyeshme) në kuadër të seminarit dyditor me temë “Etika dhe integriteti në sferën publike” i mbajtur më 2 dhe 3 dhjetor 2023, në Shtip. Korniza bazë në përgatitjen e dokumentit ishin disa referenca nga autorë ndërkombëtarë dhe vendas që trajtojnë tema në fushën e etikës, transparencës dhe llogaridhënies në politikë.

Nevoja urgjente për të krijuar standarde të tilla etike doli pa mëdyshje nga tre takime/seminare të mëparshme të përbashkëta me politikanë të rinj-alumnistë të Akademisë për Politika Publike.

Etja e tyre për njohuri të reja, motivi i sigurtë për të zgjidhur problemet me të cilat përballen, si dhe transparenca dhe respekti për Tjetrin, ishin një frymëzim i vazhdueshëm për thellimin e miqësive dhe takimeve të ndërsjella.

Prandaj, kontributi i tyre në këtë dokument është më i madhi, por në të njëjtën kohë më i vështiri sepse barra për të ardhmen u mbetet atyre.



Standardet etike përfshijnë pesë kapituj që lidhin etikën me politikën, duke mos shterur temat tjera, por duke lënë hapësirë për plotësime të mëtejshme:

I.Marrëdhëniet ndërmjet politikanëve në partinë e tyre politike;

II.Marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet politikanëve (nga parti të ndryshme politike);

III.Marrëdhëniet e politikanëve me mediat;

IV.Marrëdhëniet ndërmjet politikanëve dhe qytetarëve/sektorit qytetar;

V.Sjellja e politikanëve me pozita ekzekutive në administratën shtetërore dhe publike

I.Marrëdhëniet ndërmjet politikanëve në partinë e tyre politike;

1.I respektoj vlerat dhe parimet mbi të cilat bazohet partia ime politike. Megjithatë, jam i lirë të jap një mendim kritik dhe pres që një mendim i tillë të respektohet dhe të mos sanksionohet në asnjë mënyrë.

2. Për të arritur një qëllim më të lartë, përpiqem të njoh dhe mbështes publikisht gjithmonë interesin e përgjithshëm kundrejt interesit personal.

3. Bashkëpunoj me organet dhe trupat e partisë për promovimin e vlerave dhe parimeve etike që mundësojnë zhvillimin e plotë të demokracisë tek anëtarët e saj, veçanërisht tek anëtarët e rinj, grupet vulnerabël dhe të marginalizuar.

4. Nëse kam njohuri për keqpërdorime dhe/ose sjellje joetike në partinë time, si p.sh. kronizëm apo nepotizëm, jam i detyruar të paralajmëroj organet kompetente të partisë.

5. Faktet që ndaj në kuadër të partisë sime politike janë nga burime të verifikuara dhe sondazhe përkatëse.

II.Marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet politikanëve (nga parti të ndryshme politike);

1.Kur bëhet fjalë për interesin e përgjithshëm, përpiqem të arrij një marrëveshje dhe të kërkoj një kompromis midis qëndrimeve të ndryshme të përfaqësuara nga kolegë të partive të tjera politike.

2.Jam i/e gatshëm/e për bashkëpunim ndërpartiak për të mirën kolektive të publikut dhe interesin publik.

3.Mosmarrëveshjet që kam i zgjidh në mënyrë profesionale dhe argumentuese, pa sulme personale.

4.E respektoj jetën private, besimet dhe zgjedhjet personale në jetë dhe nuk i diskutoj kurrë hapur në debat publik.

5.Fushata negative është pjesë e domosdoshme e luftës politike, por ajo duhet të bazohet gjithmonë në fakte dhe burime të verifikuara. Fushata negative (e zezë) e bazuar në sulme personale dhe skualifikime personale nuk lejohet në ringun politik.

6.Faktet që ndaj në komunikimin ndërpartiak janë nga burime të verifikuara dhe sondazhe përkatëse.

III.Marrëdhëniet e politikanëve me mediat;

- 1.Përdor një gjuhë të qartë dhe koncize përmes së cilës ndaj informacionet përkatëse për t'u afruar me mediat dhe për të pasur një marrëdhënie korrekte me to përmes komunikimit të rregullt dhe profesional.
2. Respektoj autonominë e profesionistëve të mediave, pa ndërhyrje, detyrim apo presion ndaj tyre.
3. I shmang gjithmonë manipulimet dhe pandershmerinë në deklaratat publike.
4. Pranoj kritikën dhe sugjerimet konstruktive nga përfaqësuesit e mediave. Jam i/e gatshëm/e të kërkoj falje nëse kam keqinterpretuar disa fakte ose dezinformata të (pa) qëllimshme.

IV.Marrëdhëniet ndërmjet politikanëve dhe qytetarëve/sectorit qytetar;

- 1.Përdor informacionet e pranuar nga qytetarët/organizatat qytetare në mënyrë etike dhe të përgjegjshme. Nuk përdor informacione të ndjeshme për përfitime personale apo politike.
- 2.Në komunikim me qytetarët dhe publikun jap informacione të sakta dhe transparente.
- 3.Faktet që ndaj me qytetarët/sectorin qytetar janë nga burime të verifikuara dhe sondazhe përkatëse.

I.Politikanët me pozita ekzekutive në administratën publike

1.Si politikan/e me pozitë ekzekutive, jam personalisht përgjegjës/e për veprimet e mia dhe raportoju në mënyrë transparente për aktivitetet e mia.

2.Përgjegjësinë politike e kuptoj ekskluzivisht si përgjegjësi personale morale. Duke vepruar kështu, unë jam i/e gatshëm/e të mbaj përgjegjësi për të gjitha mospërputhjet ose parregullsitë brenda autoritetit tim, duke përfshirë situatat në të cilat ka shkelje të rënda të rregullave dhe ligjeve nga vartësit e mi.

3.Menaxhoj burimet publike dhe pronën publike në mënyrë efikase, të drejtë dhe efektive dhe nuk i keqpërdor ato për përfitime personale, për përfitime të familjes sime apo për përfitime të partisë politike.

4.Kur marr vendime të rëndësishme, konsultohem me të gjitha palët e përfshira dhe kërkoj këshilla nga palët e pavarura dhe të paanshme.

5.Në punën time udhëhiqem ekskluzivisht nga interesi publik, jo nga interesi partiak.

Referencat:

Argandoña A, Bilbeny N, Camps V, Calsina M, Castiñeira À, Palazzi C, Requejo F, Ribera R, Román B, Sàez F, Seguró M, Torralba F & Vallès JM, with the support and advice of Rosamund Thomas, *Code of Ethics for Politicians*, 2012
<https://www.raco.cat/index.php/rjjae/article/download/281020/368677>

Bliznakovski J, *Vote Selling, Party Serving and Clientelist Benefit-Seeking: Citizen Engagement in Political Clientelism in the Western Balkans* (Doctoral Thesis), Università degli Studi di Milano, Università degli Studi di Genova, Università degli Studi di Pavia, 2018/2019
https://www.researchgate.net/publication/341121617_Vote_Selling_Party_Serving_and_Clientelist_Benefit-Seeking_Citizen_Engagement_in_Political_Clientelism_in_the_Western_Balkans

Guerin B, McCrae J and Shephard M, *Accountability in Modern Government: What are the issues?* Institute for Government, 2018
www.instituteforgovernment.org.uk/publications/accountability-modern-government-issues

Harris JD, *The ethics of resignation*, Harris Foundation for Lifelong Learning, 2021
https://jonathandavidharris.info/wp-content/uploads/2021/03/The-Ethics-of-Resignation_Report_March-2021.pdf

Liddiard Patrick, *What Can Be Done About the Problem of Political Parties?*, Wilson Center, 2019
<https://www.wilsoncenter.org/publication/what-can-be-done-about-the-problem-political-parties>

Singer M. Matthew, *Buying Voters with Dirty Money: The Relationship between Clientelism and Corruption*, Department of Political Science University of Connecticut, 2009
https://www.researchgate.net/publication/228128652_Buying_Voters_with_Dirty_Money_The_Relationship_between_Clientelism_and_Corruption